



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE**  
**KUALIFIKIMEVE**

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN E**  
**MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE**

**TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:**  
**KUALIFIKIMI PROFESIONAL “AUTOMEKANIK”**  
**(Shkolla “Harry Fultz”)**

**Tiranë, 2024**

## 1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve për Kualifikimin Profesional “**Automekanik**”, 4 vjeçar, për provimin e detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testimeve përmbledhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “Automekanik” (klasa e 10-të, e 11-të, e 12-të dhe e 13-të);
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MFE nr. 27, datë 12.12.2023 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2024”.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve dhe që janë në themel të formimit teorik profesional të nxënësit.

## 2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të “Teorisë profesionale të integruar”, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Qëllimi i provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale është vlerësimi i të nxënësve dhe arritjeve si dhe përzgjedhjen e nxënësve për arsimim të mëtejshëm.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin e detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë testime të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për Kualifikimin Profesional “**Automekanik**” do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh kërkesat ndaj nxënësit, në kurrikulat përkatëse, të temave dhe çështjeve të përzgjedhura në këtë program.

Ky program përmban rreth **30%** të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve të kulturës profesionale. Në këtë program janë përfshirë ato lëndë, të cilat përbëjnë bazën kryesore dhe thelbësore për formimin profesional të nxënësve.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

### 3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “**Teorisë profesionale të integruar**” në kuadrin e provimit të detyruar “Teori profesionale e integruar”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për Kualifikimin Profesional “**Automekanik**“, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtme:

1. Teknologji Mekanike, kl. 12 dhe kl. 13;
2. Ndërtimi, përshkrimi dhe riparimi i automobilave, kl. 11; kl. 12; kl. 13;
3. Kontrolli dhe diagnostikimi i automobilave, kl. 13;

**Tabela 1: Lëndët profesionale** të përfshira në programin orientues dhe peshat e tyre përkatëse janë si më poshtë, duke konsideruar vëllimin dhe rëndësinë e tyre në formimin profesional të nxënësve.

Nr	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Teknologji Mekanike	93	27
2	Ndërtimi, përshkrimi dhe riparimi i automobilave	181	53
3	Kontrolli dhe diagnostikimi i automobilave	67	20
	<b>TOTALI</b>	<b>341</b>	<b>100%</b>

**Temat sipas lëndëve janë:**

#### a) “Teknologji Mekanike”

**(93 orë)**

**Tema 1:** Vetitë dhe provat e metaleve (11 orë)

**Tema 2:** Materialet metalike hekurore. Metalet e zeza (15 orë)

**Tema 3:** Materialet metalike jo hekurore. Metalet me ngjyrë (9 orë)

**Tema 4:** Materialet jo metalike (10 orë)

**Tema 5:** Saktësia e punimit të detaleve (4 orë)

<b><u>Tema 6:</u></b> Instrumentet matës	(2 orë)
<b><u>Tema 7:</u></b> Klasifikimi i makinave metalprerëse	(2 orë)
<b><u>Tema 8:</u></b> Punimet në makinat tornuese	(6 orë)
<b><u>Tema 9:</u></b> Njohuri për punimet në makinat shpuese	(6 orë)
<b><u>Tema 10:</u></b> Njohuri për punimet në makinat barenuese	(6 orë)
<b><u>Tema 11:</u></b> Punimet në makinat tërheqëse (shtytëse)	(6 orë)
<b><u>Tema 12:</u></b> Makinat zdruqese (limatricet dhe stokatrixcet)	(6 orë)
<b><u>Tema 13:</u></b> Punimet në makinat frezuese	(10 orë)

**b) “Ndërtimi, përshkrimi dhe riparimi i automobilave” (181 orë)**

<b><u>Tema 1:</u></b> Bazat e motorit dhe puna e tij	(6 orë)
<b><u>Tema 2:</u></b> Ndërtimi dhe klasifikimi i motorëve	(2 orë)
<b><u>Tema 3:</u></b> Ndërtimi i pjesës së sipërme të motorit	(4 orë)
<b><u>Tema 4:</u></b> Pjesa e poshtme e motorit. Ndërtimi i bllokut të cilindrave	(2 orë)
<b><u>Tema 5:</u></b> Pjesa e përparme e motorit	(2 orë)
<b><u>Tema 6:</u></b> Sistemi i ushqimit dhe pjesët përbërëse të tij	(2 orë)
<b><u>Tema 7:</u></b> Bazat e sistemit të ushqimit me injeksion benzine	(6 orë)
<b><u>Tema 8:</u></b> Sistemi i ushqimit me injeksion naftë	(2 orë)
<b><u>Tema 9:</u></b> Sistemi i daljes së gazeve	(2 orë)
<b><u>Tema 10:</u></b> Turbinat, kompresorët	(2 orë)
<b><u>Tema 11:</u></b> Teknologjia e sistemit të ftohjes	(6 orë)
<b><u>Tema 12:</u></b> Sistemi i vajosjes, qëllimi dhe funksionet e tij	(4 orë)
<b><u>Tema 13:</u></b> Freksioni, qëllimi dhe parimi i punës së tij	(6 orë)
<b><u>Tema 14:</u></b> Teknologjia e kamjove manuale	(4 orë)
<b><u>Tema 15:</u></b> Teknologjia e kamjove automatike	(4 orë)
<b><u>Tema 16:</u></b> Teknologjia e sistemit të transmetimit të fuqisë në rrotat aktive	(6 orë)
<b><u>Tema 17:</u></b> Diferenciali dhe semiakset e rrotave të pasme aktive	(6 orë)
<b><u>Tema 18:</u></b> Gomat, rrotat dhe kushinetat e tyre	(3 orë)
<b><u>Tema 19:</u></b> Teknologjia e sistemit të suspensionit. Funksionet e tij	(3 orë)
<b><u>Tema 20:</u></b> Teknologjia e sistemit të drejtimit. Funksionet e tij	(3 orë)
<b><u>Tema 21:</u></b> Teknologjia e sistemit të frenimit. Pjesët përbërëse të sistemit të frenimit	(6 orë)
<b><u>Tema 22:</u></b> Bazat e sistemit të ngrohjes dhe ajrit të kondicionuar	(6 orë)
<b><u>Tema 23:</u></b> Pajisjet elektrike matëse dhe testuese	(3 orë)
<b><u>Tema 24:</u></b> Skemat elektrike dhe llojet e tyre në automobila	(3 orë)
<b><u>Tema 25:</u></b> Teknologjia e baterisë 12V dhe baterisë së tensionit të lartë	(6 orë)
<b><u>Tema 26:</u></b> Sistemi i lëshimit të motorit	(9 orë)
<b><u>Tema 27:</u></b> Teknologjia e sistemit të ngarkimit	(9 orë)
<b><u>Tema 28:</u></b> Teknologjia e sistemit të dhënies së shkëndijës elektrike	(12 orë)
<b><u>Tema 29:</u></b> Dritat, instrumentet në kroskot, fshirëset e xhamit, buria, ndërtimi dhe parimi i punës	

se tyre	(16 orë)
<b>Tema 30:</b> Shërbimi i baterisë 12V dhe i baterisë së tensionit të lartë (HV)	(8 orë)
<b>Tema 31:</b> Testimi, mirëmbajtja dhe riparimi i sistemit të ftohjes	(4 orë)
<b>Tema 32:</b> Diagnostikimi, testimi dhe riparimi i sistemit të lubrifikimit	(4 orë)
<b>Tema 33:</b> Riparimi i bllokut të cilindrave dhe punimet mekanike	(4 orë)
<b>Tema 34:</b> Diagnostikimi, shërbimi dhe riparimi i freksionit	(4 orë)
<b>Tema 35:</b> Diagnostikimi, shërbimi dhe riparimi i kamjos manuale	(4 orë)
<b>Tema 36:</b> Diagnostikimi, shërbimi dhe riparimi i transmisionit kardanik dhe kutive të transmetimit të fuqisë	(4 orë)
<b>Tema 37:</b> Diagnostikimi, shërbimi dhe riparimi i sistemit të frenimit	(4 orë)

**c) “Kontrolli dhe diagnostikimi i automobilaëve” (67 orë)**

<b>Tema 1:</b> Bazat e sistemit kompjuterik në makina	(5 orë)
<b>Tema 2:</b> Elektronika digjitale	(7 orë)
<b>Tema 3:</b> Puna e kompjuterit. Pjesët e kompjuterit	(6 orë)
<b>Tema 4:</b> Vepruesit dhe funksioni i tyre	(15 orë)
<b>Tema 5:</b> Sistemi i diagnostikimit OBD dhe pajisjet skanuese	(20 orë)
<b>Tema 6:</b> Shërbimi i sistemeve kompjuterike	(6 orë)
<b>Tema 7:</b> Procedura e shërbimit të sensorëve	(8 orë)